



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 104/ 02-28122/23
Kaçanik, 30.11.2023

Në mbështetje të nenit 12.2(d) lidhur me nenin 82.2 të Ligjit Nr. 03 L-040 për Vetëqeverisje lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 53 pika 3 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/21 Qershor 2016), të nenit 6.2 të Statutit të Komunës, duke vendosur sipas Kërkesës së MAPL 020-780/4 të datës 27.10.2023, numri i Protokollin të komunës 01Nr. 104/02-28124/23 i datës 30.10.2023, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 30 nëntor 2023, merr këtë:

VENDIM

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIM 01NR. 104/02-24408/23 PËR SHPALLJE ME INTERES TË PËRGJITHSHËM PUBLIK PJESËN E PARCELËS KADASTRALE 00153-24 ZONA KADASTRALE KAÇANIK NË EMËR TË RAMIZ SHAQIRI PËR KËMBIM ME PJESËN E PARCELËS KADASTRALE 01908-15 PRONË SHOQËRORE KOMUNA KAÇANIK

1. Me këtë Vendim SHFUQIZOHET Vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 104/02-24408/23 i datës 27.09.2023 për shpallje me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës kadastrale 00153-24 zona kadastrale Kaçanik në emër të Ramiz Shaqiri për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 01908-15 pronë shoqërore Komuna Kaçanik.
2. Shfuqizimi i vendimit nga pika 1. e këtij vendimi, bëhet me Kërkesën e MAPL se i njëjti është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi, pasi prona fillimisht duhet të jetë e shpallur nga Kuvendi i Komunës me interes, pastaj të merret vendimi për këmbim të pronave.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit (përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe mekanizma tjerë relevantë); Drejtoria e Buxhetit dhe Financave; Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli



01Nr. 104/02-24408/23
Kaçanik, 27.09.2023

Në bazë të dispozitave të nenit 12.2 (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokal (Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershor 2008), nenit 25 paragrafi 1, 2, dhe 3 të Ligjit nr.06/L- 092 -për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme (Gazeta Zyrtare Nr. 10/03 Prill 2019), të nenit 6 (h) të Statutit të Komunës së Kaçanikut, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës së Kaçanikut nëpërmjet DUKMM 01Nr.104/02-24408/23 (bashkëngjitur), Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur me 27 shtator 2023, mori këtë:

VENDIM


PËR SHPALLJE ME INTERES TË PËRGJITHSHËM PUBLIK PJESËN E PARCELËS KADASTRALE 00153-24 ZONA KADASTRALE KAÇANIK NË EMËR TË RAMIZ SHAQIRI PËR KËMBIM ME PJESËN E PARCELËS KADASTRALE 01908-15 PRONË SHOQËRORE KOMUNA KAÇANIK

1. Me këtë Vendim, SHPALLET me interes të përgjithshëm publik pjesa e parcelës kadastrale 00153-24, e cila gjendet në Zonën kadastrale Kaçanik, në sipërfaqe 27.47m².
2. Këmbimi i paraparë me këtë Vendim nënkupton:
 - 2.1 Pjesa e parcelës kadastrale 00153-24, me sipërfaqe 27.47m², me pronar Ramiz Shaqiri nga Kaçaniku, këmbëhet me pjesën e parcelës kadastrale 01908-15, me sipërfaqe 42.41m², e cila në shënimet e Zyrës Kadastrale të Kaçanikut shënohet si Pronë Shoqërore, Komuna Kaçanik. Pronat e lartpërmendura gjenden në Zonën Kadastrale Kaçanik.
3. Qëllimi i shpalljes me interes të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës kadastrale nga pika 1. e këtij vendimi, është për zgjerimin e rrugës "Emsale Frangu" përmes së cilës kalojnë nxënësit e SHFMU "Emin Duraku", banorët e asaj pjese dhe qytetarët tjerë të cilët e shfrytëzojnë atë rrugë.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë shkresat e lëndës: Propozim Vendimi i Kryetarit, arsyetuar nga DUKMM, Certifikatat e pronësisë, Manuali i studiuar nga gjeodeti i licencuar.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit (përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe mekanizma tjerë relevantë); Drejtoria e Buxhetit dhe Financave; Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Data	30.10.23	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.		Numri	104/02-24408/23
	01	Shtojcë	20722

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, U. d Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Nga:	Besim Myrtezani, U. d Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL Datë: 16.10.2023 Nr: VI-020-780
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullos (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimin 01 Nr. 104/02-24408/23 për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës kadastrale 00153-24 zona kadastrale Kaçanik në emër të Ramiz Shaqiri për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 01908-15 pronë shoqërore Komuna Kaçanik
E miratuar më datë: 27.09.2023
E parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 05.10.2023

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjisllacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut në mbledhjen e mbajtur me datë 27.09.2023, ka miratuar Vendimin 01 Nr. 104/02-24408/23 për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës kadastrale 00153-24 zona kadastrale Kaçanik në emër të Ramiz Shaqiri për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 01908-15 pronë shoqërore Komuna Kaçanik.

Vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut është në *kundërshtim* me Ligjin 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, përkatësisht Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, *paragrafin 5 të nenit 29 ku përcaktohet se "Prona që kërkohet të këmbëhet, paraprakisht duhet të jetë shpallur nga kuvendi i komunës pronë me interes publik, përveç nëse nevoja për pronën e tillë arsyetohet në planin zhvillimor të komunës"*.

Vendimi 01 Nr. 104/02-24408/23 për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës kadastrale 00153-24 zona kadastrale Kaçanik në emër të Ramiz Shaqiri për këmbim me pjesën e parcelës kadastrale 01908-15 pronë shoqërore Komuna Kaçanik, duhet të rishqyrtohet sepse njëherë duhet të miratohet Vendimi për shpalljen e interesit publik e pastaj të miratohet vendim për këmbim të pronës.

Bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Kaçanikut duhet të ndërmerr veprime dhe brenda afatit ligjor të rishqyrtoj aktin dhe të harmonizoj më legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.